



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**ZL.Anr.734/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevc gjyqtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Bashkim Latifi, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Bashkim Latifi, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura me datë 22.10.2017.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017 në ora 15:20, nga Bashkim Latifi, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën thekson se apelin e paraqet për vendotimet: 1831e/02D, 1815e/01R, 1815e/02R, 1820e/03D, 1825e/01D, 1833e/02D, 1808e/01R.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## **Apeli është i pabazuar**

PZAP-i, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit gjeti se me asnjë provë bindëse nuk janë dëshmuar pretendimet ankimore dhe ankuesi nuk i ka identifikuar se sa vota i mungojnë për vendvotimet e cekura në ankesë. Po ashtu nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar pretendimet. Prandaj Paneli ankesën e ankuesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzoi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.734/2017 me datën 11.11.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

**Rafet Haxhaj**



### ***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*